

## Fakte mbi Aktivitetin Filantropik

### Dhjetor 2016

Partnerët Shqipëri, si pjesë e misionit të saj në mbështetje të sektorit jo-fitimprurës në Shqipëri dhe forcimit të bashkëpunimit ndërsektorial, po punon për zhvillimin e filantropisë në vend. PSH ka realizuar:

- një seri studimesh mbi nivelin e zhvillimit të filantropisë në vend (**Sipërmarrja dhe Filantropia-Raport i Studimit, Një Vështrim Historik mbi Zhvillimin e Filantropisë në Shqipëri, Raporti i monitorimit të aktivitetit filantropik në Shqipëri gjatë vitit 2015**),
- ndërhyrje afatgjata që synojnë evidentimin e këtij aktiviteti nga ana e sektorit të biznesit (**Çmimi i Filantropisë**),
- krijimin e platformave që sjellin më pranë biznesin me nisma që promovojnë

përfshirjen sociale dhe zhvillimin ekonomik lokal (**Konkursi i Ideve të Gjelbërta**).


Për të dytin vit radhazi Partnerët Shqipëri po kryen monitorimin e aktivitetit filantropik në Shqipëri nëpërmjet hulumtimit të medias, përfshi edhe ato sociale, si dhe burimeve të informacionit nga institucionet publike dhe jo-publike.

Hulumtimi kryhet mbi baza ditore dhe gjetjet paraqesin çështjet e mbështetura, natyrën dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik si dhe natyrën e dhuruesve. Ato vijnë në formën e informacionit të përmbledhur mujor që synon të ndihmojë në kuptimin dhe evidentimin e këtij aktiviteti.


**Mbledhja e të dhënave mbështetet nga Catalyst**

Gjatë muajit Dhjetor 2016 vlera e dhurimit të raportuar në nivel vendi është 11,941,200 Lekë, sipas të dhënave të mëposhtme.


**Vlera e Dhurimeve sipas Natyrës**




**Numri i Dhurimeve**




## Vlera e Dhurimeve sipas Natyrës së Dhuruesve




## Numri i Dhuruesve<sup>1</sup>




## Përfituesit




## Shtirja Gjeografike e Përfituesve



## Kanalet e Dhurimit



## Shtirja Gjeografike e Dhuruesve



Për muajin Dhjetor 2016 të gjitha dhurimet kanë shkuar për fushën e **Ndihmës Ekonomike** për zbutjen e varfërisë. Vlera e dhurimit të raportuar nuk përfshin 728 pako me ushqime dhe veshmbathje.

<sup>1</sup>Për hater të kësaj analize dhuruesit llogariten vetëm një herë pavarësisht numrit të dhurimeve të kryera gjatë periudhës së monitoruar, e cila reflektohet tek grafiku "Numri I Dhurimeve".